


Prof.Dr.Hfz.

Hajredin Hoxha

PAKICAT ISLAME
NË EVROPËN PERËNDIMORE
DHE LINDORE

- aktualiteti dhe shpresa -



Prof.Dr.Hfz. Hajredin HOXHA

**PAKICAT ISLAME NË
EVROPËN PERËNDIMORE
DHE LINDORE**

- aktualiteti dhe shpresa-

Përktheu:

Sedat ISLAMI

Dr. Hajredin HOXHA

**PAKICAT ISLAME NË EVROPËN PERËNDIMORE
DHE LINDORE**

- aktualiteti dhe shpresa-

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës.

Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për afirmim të kulturës së leximit në përgjithësi. Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi pa lejen paraprake me shkrim të autorit.

PËRKTHEU NGA ARABISHTJA:
Sedat ISLAMI

Titulli në origjinal:

Dr. Hajruddin Huxheh,
*El Xhalijat el-Islamijeh fi Urubba el garbijeh ve'sh sherkijeh – el
vakiu ve'l emel,*

edicioni i parë, Metabiu'rr Rreshid, Arabia Saudite, 2010.

Recensent: Ajni Sinani

Redaktore gjuhësore: Mimoza Sinani

Dr. Hajredin HOXHA

**PAKICAT ISLAME NË EVROPËN PERËNDIMORE
DHE LINDORE**

- aktualiteti dhe shpresa-

Përmbajtja

Hyrje: Vështrim gjendjes së muslimanëve në Evropën perëndimore dhe lindore
– Vështrim gjendjes faktike dhe shpresës

Kapitulli I: Si e shikojnë perëndimorët Islamin?

Kapitulli II: Muslimanët në Gadishullin Ballkanik – Evropën Lindore

Kapitulli III: Rekomandimet dhe ligjet aplikimi i të cilave kërkohet si kusht për garantimin e të drejtave të pakicave muslimane

Përfundim

Hyrje¹

Falënderimet i takojnë Allahut të Madhëruar! Përshëndetjet qofshin mbi të Dërguarin e Tij, Muhammedin, familjen, shokët dhe të gjithë pasuesit e tyre gjer në amshim!

Falënderimi i takon Allahu që bashkoi ummetin për përkrahjen e krijesës më të mirë (Muhammedit, alejhi's selam)!

Falënderimi i takon Allahut që bëri dijetarët e sinqertë të sqarojnë dhe përhapin sunnetin e Zotërisë së të gjithë pejgamberëve, Muhammedit, alejhi's selam!

Falënderimi i takon Allahut që inspiroi liderët dhe pushtetarët muslimanë që të bashkohen tok kundër të gjithë atyre që cenojnë parimet e shenjta islame! O Zoti ynë! Bekoje atë mund dhe ato përpjekje për hir të kësaj dite të dëshmuar dhe mos na privo nga e mira Jote e premtuar, ngase Ti, Zoti ynë, je më i Miri prej atyre që luten dhe më i Ndershmi prej atyre në të cilët shpresohet!

Falënderimet i takojnë Allahut që e dërgoi të Dërguarin me udhëzim të drejtë dhe fe të vërtetë që të ngadhënjejë mbi çdo fe, edhe pse idhujtarët e urreyen dhe urrejnë këtë.

Falënderimi i takon Allahut që thotë:

Muhammedi është i dërguar i All-llahut...” Kur’ani, el-Fet’hu, 29.

Në mos e ndihmofshit atë (Pejgamberin), atë e ka ndihmuar All-llahu; kur ata që nuk besuan e nxorën atë vetë të dytin; kur që të dy ishin në shpellë, kur po i thoshte shokut të vet: "Mos u pikëllo (friko), All-llahu është me ne!" E All-llahu i zbriti qetësi (në shpirtin e) atij, e fuqizoi me një ushtri që ju nuk e patë; e fjalën e atyre që nuk besuan e bëri më të ultën, kurse fjala e All-llahut (është) më e larta. All-llahu është më i fuqishmi, më i urti.” Kur’ani, et-Teubeh, 40.

E Ne të dërguam ty (Muhammed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat.” Kur’ani, el-Enbija, 107.

¹ Ky studim në fakt është një referim në Konferencën Ndërkombëtare për Përkrahjen e Pejgamberit Muhammed, Bahrejn 22-23 mars 2006.

VËSHTRIM GJENDJES SË MUSLIMANËVE NË EVROPËN PERËNDIMORE DHE LINDORE

(VËSHTRIM GJENDJES FAKTIKE DHE SHPRESËS)

Parathënie

Islami daton në Evropë qysh në vitin 711 kur u çlirua Andaluzia dhe muslimanët u vendosën në të për plot tetë shekuj, respektivisht nga viti 771-1492.

Me rënien e Shtetit Islam në Spanjë dhe largimin e dhunshëm të muslimanëve, në pushtet erdhi Shteti Osman, i cili filloi dalëngadalë të shtrijë sundimin e vet në Ballkan, në Evropën Lindore. Pushteti osman vazhdoi deri me përfundimin e Luftës së Parë Botërore. Ballkani popullohet nga një numër i madh muslimanësh në Bosnjë e Hercegovinë, Maqedoni, Kosovë dhe Shqipëri. Madje këto dy shtetet e fundit janë të vetmet në Evropë me shumicë muslimane².

Prania e muslimanëve në Evropën perëndimore pas Luftës së II-të Botërore llogaritet si dukuri e re. Disa prej tyre erdhën si emigrantë, ndërsa të tjerët u sollën nga kolonizatorët si fuqi punëtore për përsheptimin e progresit dhe zhvillimit ekonomik. P.sh. anglezët sollën shumë muslimanë nga nënkontinenti indian, francezët sollën muslimanë nga Afrika veriore, holandezët nga Indonezia, ndërsa gjermanët që nuk kolonizuan asnjë vend, sollën punëtorë nga Turqia. Në shtetet e tjera evropiane, muslimanët depërtuan nëpërmjet emigrimit dhe sot numri i përgjithshëm i muslimanëve në Evropë llogaritet të jetë jo më pak se dhjetëra miliona. Padyshim, muslimanët e rinj nuk kanë arritur ta kuptojnë siç duhet kulturën perëndimore.

Në të dy Amerikat, prania e muslimanëve është shtuar dukshëm në vitet e 60-ta dhe 70-ta, ndërsa në Kanada kanë depërtuar vetëm muslimanët me përgatitje dhe shkathtësi të larta, politike kjo e papërfillur në Amerikë. E tëra ajo që iu interesonte amerikanëve ishte që emigrantët të përvetësonin gjuhën angleze si dhe të kuptonin ligjin, kulturën, traditat dhe zakonet amerikane.

² Për më shumë njohuri rreth vuajtjeve dhe mundimeve të muslimanëve në Gadishullin Ballkanik shih: Abiva Huseyin, *Muslim Minorities Face Increasing Hostility in the Balkans*, *The International Message* – North America's Magazine, September 1991, f. 21-22.

Nëse puna ishte kështu me muslimanët në vendet e sipërpërmendura, në Ballkan muslimanët patën fat të hidhur nën sistemin komunist. Ata përjetuan një tmerr të vërtetë. Komunistët ishin të vëmendshëm që të ngjallin ndjenjat e urrejtjes ndaj shtetit osman tek popujt që ishin nën sundimin e tyre. Komunistët i penguan pasuesit e këtyre feve nga komunikimi ndërmjet vete. Përpjekja e boshnjakëve për krijimin e një zone të përbashkët, e cila do të shquhej për tolerancë fetare ndërmjet muslimanëve, serbëve dhe kroatëve, rezultoi e papranuar nga këta të fundit, pra serbët dhe kroatët³.

Çështja e pluralizmit fetar në Evropën perëndimore mbetet ende *pemë e papjekur*. Evropa perëndimore ka një histori fetare të zezë dhe gjakatare, e shembull konkret për këtë është lufta e boshnjakëve dhe kosovarëve me serbët. Shumë muslimanë perëndimorë ndajnë mendimin se kjo luftë, në fakt, ishte ndërmjet Islamit dhe Perëndimit. Imazhet e kësaj lufte në Bosnjë dhe Kosovë u portretizuan me shumë tanke dhe topa luftarakë. Në perëndim çështja ka të bëjë me aspektin psikik ose nxjerrjen e ligjeve dhe rregullave të ashpra përkitazi me muslimanët. Në perëndim ndodh marginalizimi i Islamit dhe muslimanëve, sulmi dhe dhuna mediale kundër vlerave dhe parimeve islame, akuzimi për terrorizëm, fundamentalizëm dhe dhunë etj. Në Evropë gjen ekstremistë të atillë që bëjnë thirrje për riatdhesim të muslimanëve në vendet e tyre, ndërsa përpjekjet e qarqeve fetare për gjetjen e zgjidhjeve dhe mënyrave të bashkëjetesës, bashkëpunimit dhe mirëkuptimit, kanë dështuar.

Vlugu i emigrantëve të shumtë muslimanë në Britani bëri që shteti të nxirrte ligje strikte përkitazi me procedurat e hyrjes në Britani, konkretisht të mos lejonte hyrjen perverse me viza zyrtare. Kjo bëri që disa politikanë, si Enoch Powell, të mendonin se mund të pritej luftë civile ndërmjet ithtarëve të kulturave të ndryshme. Këtë frikë, pas shtimit të emigrantëve, e kishte shfaqur edhe ish-kryeministrja Mrs. Thatcher.

Disa hulumtues, gjendjen e muslimanëve në perëndim, e kanë klasifikuar në:

- Periudhën para publikimit të librit të Selman Rushdit, dhe
- Periudhën e pastajme.

Por mendoj se është me vend që të bëjmë edhe një klasifikim tjetër, jo vetëm në perëndim por në tërë botën, si vijon:

³ Për më shumë shih: Lopasic, Alexander, *Islamization of the Balkans with Special Reference to Bosnia*, (Journal of Islamic Studies), 5:2, (1994), pp.163-182; Abid, Safet, *Europe's Endangered Species: Yugoslavia's Forgotten Muslims – A survey of the indigenous muslims of Bosnia and Herzegovina – Past history – Current situation – Future prospects*, (The message International), September 1991, pp.23-26.

- Gjendja para 11 shtatorit (2001)
- Gjendja e mëpastajme.

Sikur që nuk do të ishte gabim që këto gjendje të klasifikoheshin dhe në:

- Gjendja para rastit të Danimarkës (ku u ofendua Pejgamberi Muhammed në mediat e shkruara të tyre), dhe
- Gjendja e mëpastajme.

KAPITULLI I:

SI E SHIKOJNË PERËNDIMORËT ISLAMIN?

Disa analistë kanë vënë re se një vështrim objektiv dhe global i marrëdhënieve të perëndimit me Islamin zbulon se në perëndim në fakt janë *dy islama* e jo një, siç do të duhej të ishte. *I pari* është Islami për të cilin hulumtojnë orientalistët në qendrat dhe universitetet e tyre, dhe këtë për qëllime politike, shoqërore, fetare dhe kolonialiste. Ndërsa *i dyti* është Islami ashtu siç i paraqitet audiencës nga mediat, e që s'do mend se ai paraqitet i djallëzuar dhe fajtor për të gjitha problemet që ndodhin sot në botë. Fatkeqësisht, ky mendim për Islamin mbizotëron në perëndim⁴ dhe këtu qëndron shkaku i vuajtjeve të muslimanëve perëndimorë.

Analistët po kështu kanë tërhequr vërejtjen se në perëndim sot diskutohet mbi mundësinë e ndarjes së Islamit në rrafsh të tjera, respektivisht në:

- Islam në Evropë, dhe
- Islam evropian⁵.

Ndarja e parë (Islami në Evropë) nënkupton refugjatët dhe emigrantët muslimanë që shkojnë në Evropë, e që në të shumtën e rasteve vendosen nëpër kantone, ku janë të izoluar nga rrethi dhe shoqëria e atij vendi. Ndërsa *ndarja e dyte* (islami evropian) nënkupton se Evropa ka një pozitë gjeografike ndryshe nga gjeografia arabe apo islame, kështu që ka të drejtën e formimit të një Islami që i përshtatet realitetit, ambientit dhe rrethanave të saj shoqërore dhe racore. Autori mendon se nuk ka diç të keqe në këtë ndarjen e dytë, ngase realiteti islam ndërkombëtar e dëshmon këtë gjë praktikisht, siç është p.sh. islami indonezian, malajzian, turk, boshnjak, kosovar⁶, egjiptian, emiratin, sudanez, sirian etj⁷.

⁴ Për të kuptuar më shumë rolin famëkeq të orientalistëve në shtrembërimin e imazhit islam, shih punimin në dorëshkrim të autorit (H.H): *Devru-l-musteshrikine fi teshvihi sureti-l-Islam* (Roli i orientalistëve në shtrembërimin e imazhit islam).

⁵ Rreth kësaj çështjeje shkencore kanë diskutuar një numër hulumtuesish bashkëkohorë, e ndër më të mirët që kanë shkruar në këtë drejtim është Dr. Tarik Ramadan, me origjinë arabe por me edukim perëndimor, i cili ka shkruar librin "*How to be a European Muslim*."

⁶ www.islammemo.cc, artikull i ish-presidentit boshnjak, Alija Izetbegović: *Ru'jetu Alija Izetbegovic li ved'i-l-muslimine fi Urubba*.

⁷ Rreth gjendjes së muslimanëve në Evropën perëndimorë, Bosnjë, Kosovë dhe Evropën lindore, kthehu tek: www.islammemo.cc, respektivisht artikulli i presidentit të ndjerë boshnjak, Alija

Disa studime dhe hulumtime tregojnë se muslimanët janë cak dhe synohen nga e *djathta ekstremiste* në përfundim, ndërsa është gjë më se e vërtetë se “lufta” është duke u zhvilluar ndërmjet të djathtës evropiane dhe muslimanëve të saj. Në Francë, lideri i partisë së frontit kombëtar është i njohur për armiqësinë e tij ndaj arabëve dhe refuzimin në vazhdimësi të lejimit të ndërtimit të xhamive për ta. Madje ka një moto: “*Franca është e francezëve dhe jo e arabëve dhe muslimanëve!*”

Kjo parti konsiderohet si parti amë e grupeve radikale, siç janë p.sh. nazistët e rinj (neo-nazistët).

Kësaj urrejtjeje nuk i shpëtuan as muslimanët e Belgjikës, të cilët pas ngjarjeve të 11 shtatorit u kërcënuan me vrasje, djegie të shtëpive dhe pronave dhe me internim të dhunshëm⁸. Të gjithë mbetën të shtangur kur në muret e xhamisë në Bruksel panë mbishkrimet e dhunshme që thërrisnin për urrejtje ndaj arabëve dhe largimin e muslimanëve nga Belgjika, me gjithë faktin që kushtetuta e kësaj të fundit parasheh transparencë në lirinë fetare dhe atë të shprehjes së individit.

Disa analistë mendojnë se këto veprime kanë qenë individuale nga pjesëtarë të rrymave djathtëse ekstreme dhe se ngjarjet e 11 shtatorit kanë shkaktuar reagime negative ndaj pakicave islame për shkak të pretendimit amerikano-sionist se prapa këtyre veprimeve qëndrojnë muslimanët. Ky qëndrim sikur i motivoi shtetet evropiane për një trajtim më të ashpër të muslimanëve dhe për një kontroll më të rreptë ndaj aktiviteteve të tyre, si dhe për t'i ngrirë llogaritë bankare të tyre, gjë që padyshim iu shkaktoi një humbje të madhe muslimanëve në Evropë dhe Amerikë, e në veçanti shoqatave bamirëse që ndihmonin skamnorët muslimanë.

Shifra e xhamive dhe faltoreve në Belgjikë është diku 290, ndërsa shifra në total e muslimanëve në Bashkimin Evropian është jo më pak se 25 milionë. Kësisoj, muslimanët përbëjnë komunitetin e dytë më të madh fetar në Belgjikë, duke e tejkaluar kështu atë çifut dhe protestant. Belgjika ka aplikuar mësimin e lëndës fetare islame krahas feve të tjera që nga viti 1975, ndërsa mësues fetarë muslimanë janë afër 700, të cilët japin mësim, në të gjitha anët e vendit, nga dy orë në javë lëndën për fenë islame. Vlen të theksohet se është shteti ai që siguron të ardhurat mujore për të shtatëqind mësuesit dhe mësueset e sipërpërmendura⁹.

Izetbegoviç, “*Ru’jetu Alija Izzet Begovic le ved’i-l-muslimine fi Urubba*” (Gjendja e muslimanëve në Evropë nga këndvështrimi i Alija Izetbegoviçit).

⁸ Shih: En-Nahvi, Adnan Ali Rida, *El muslimune bejne-l-vakii ve-l-emel*, b1, 2003. Daru-n-Nahvijj li-n-neshri ve-t-tevzië.

⁹ Shih: “*El muslimune fi Belgjika*” në www.islammemo.cc

Ndërsa sa i përket gjendjes së muslimanëve në Amerikë, sipas revistës “US NEWS AND WORLD REPORT”, qeveria amerikane ka nën vëzhgim të rreptë 120 xhami dhe qendra të frekuentuara nga muslimanët dhe këtë, sipas asaj që parafrazon apo paragjykon qeveria amerikane, për të kërkuar për “bombat të mundshme nukleare.”

Revista në fjalë nënvizon se qeveria amerikane ka vëzhguar nga afër xhami, shtëpi, qendra tregtare dhe qendra të tjera të ngjashme, të cilat janë frekuentuar nga muslimanët amerikanë në Uashington dhe në pesë shtete të tjera të mëdha, dhe këtë me pretekst të preventivit të ndonjë operacioni terrorist të mundshëm. Analistët muslimanë e shohin këtë paksa të tepërt për faktin se qeveria amerikane nuk ka as dëshminë më të vogël që do ta bënte të dyshonte te muslimanët amerikanë. Ata –siç theksojnë analistët në fjalë- janë pjesë përbërëse e popullit amerikan, duke shtuar se kjo do të reflektojë keq në raportet ndërmjet pakicave muslimane dhe administratës amerikane dhe se për sa kohë liria dhe të drejtat e amerikanëve muslimanë mohohen brenda SHBA-ve, atëherë kjo do të jetë një krizë për Uashingtonin që të përfitojë mendjet dhe zemrat e muslimanëve anembanë botës.

Liderët e pakicave muslimane kanë kërkuar prej Kongresit që t’iu japë sqarime dhe garanci nëse është shkelur kushtetuta përkitazi me procedurat e aplikuara për të ekzekutuar ligjin që njihet si “USA patriot act”, e i cili nuk legjitimon për vëzhgim dhe monitorim të vendeve të veçanta¹⁰.

Ndërsa gjendja e muslimanëve në Francë qëndron shumë më keq. Kjo për shkak se fobia ndaj Islamit në këtë vend është e theksuar më shumë pothuajse kudo tjetër dhe se, sipas tyre, çdo musliman patjetër se është terrorist kështu që duhet larguar me njërin apo tjetrën mënyrë. Ndërsa për xhamitë mendojnë se duhen pastruar nga promotorët e terrorizmit (hoxhallarët) dhe se shtetet evropiane nuk duhet t’i lejojnë hoxhallarët e jashtëm që vijnë nga shtetet islame. Në vend të kësaj, si alternativë, kanë përmendur themelimin e instituteve të veçanta për përgatitjen profesionale të imamëve dhe ligjëruesve muslimanë. Është për t’u çuditur se si muslimanëve, me gjithë faktin se janë afër 4 milionë në Francë, nuk iu dëgjohe zëri në kohën kur çifutëve, që nuk janë hiç më shumë se 600.000, jo vetëm që iu dëgjohe zëri, por edhe kanë ndikim, madje *e ngrenë tërë botën në këmbë...*¹¹

Holanda ka aplikuar një mënyrë tjetër të kontrollit ndaj muslimanëve. Ministria e Punëve të Brendshme ka lëshuar një dekret ku urdhëron që të gjithë imamët dhe

¹⁰ Shih: “Kul-lu muslimi-Amerika tahte-rr-rrekabeli” në www.islammemo.cc

¹¹ Shih: “Kejfe jendhuru el-Garbu ile-l Islam”, në www.islammemo.cc

ligjëruesit muslimanë ta mësojnë gjuhën e vendit, në mënyrë që ligjëratat e së premtës, për të cilat –me sugjerime nga jashtë- kishin frikë se nxisin për dhunë dhe terror, të mbahen jo në arabishte por në gjuhën holandeze, për ta pasur më të lehtë kështu kontrollin mbi aktivitetet e tyre.

Fatbardhësisht, këto ndasi nuk mund t'i gjesh në Zvicër. Muslimanët në Zvicër shfrytëzojnë mundësitë që ua jep liria, kështu që kërkojnë nga shteti që ta pranojë fenë e tyre zyrtarisht sikurse që kërkojnë lehtësimin e regjimit të pajisjes me nënshtetësi zvicerane. Prej më shumë se dy dekadave në Zvicër jetojnë jo më pak se gjysmë milioni muslimanë, të përbërë nga shqiptarë (shumica), turq, boshnjakë, arabë dhe aziatikë. Jeta dhe gjendja e tyre është më e mirë se kudo tjetër në vendet perëndimore.

Ndoshta shkaku kryesor i kësaj mirësjellje zvicerane është fakti se Zvicra kurrë nuk ka qenë kolonizatore. Analistët muslimanë thonë se asnjë musliman nuk mund të ankohet në Zvicër; ne jetojmë paqësisht dhe disponojmë të drejta, liri dhe drejtësi, gjëra këto që ndoshta nuk i kemi as në vendet tona. Pushteti zviceran, për dallim nga shumë qeveri perëndimore, i trajton me transparencë, lehtësi dhe drejtësi pakicat islame, duke mos i fajësuar kolektivisht për fajet e disave prej tyre¹².

Stabilitetin dhe prehjen shpirtërore dhe ideore të muslimanëve zviceranë shumë analistë e komentojnë me faktin se refugjatët muslimanë me një bagazh dije dhe kulture nuk kanë menduar dhe vepruar me mentalitetin e një vizitori apo të huaji por me atë të një qytetari zviceran të barabartë me të tjerët. Me gjithë këto, për shkak të dezinformatave dhe propagandës mediatike, populli zviceran mbështet idenë e *konflikteve kulturore dhe përplasjeve të qytetërimeve*.¹³

Ndërsa në Spanjë janë regjistruar disa raste raciste ndaj arabëve dhe muslimanëve, duke i dëmtuar madje materialisht pronat dhe veturat e tyre. Shkaku i kësaj fshihet në urrejtjen që ata kanë ndaj “luftëtarëve” – siç i quajnë muslimanët- për çka kërkojnë me këmbëngulësi largimin e tyre nga Spanja.

Analistët kanë zbuluar se mbase ekziston një ide e promovuar nga shumë shtete perëndimore për t'i zhveshur muslimanët nga çfarëdo roli, në mënyrë që kjo t'i mbajë ata larg njëri tjetrit.

¹² Shih: “*El muslimune fi Svisra*”, në www.islammemo.cc

¹³ Ibid.

KAPITULLI II:

MUSLIMANËT NË GADISHULLIN BALLKANIK – EVROPËN LINDORE¹⁴

Është shkruar nga perëndimorët për muslimanët e Ballkanit dhe Evropës lindore, por ato shkrime dallohen për sfondin e tyre joobjektiv dhe për vështrime pothuajse personale. Madje ato janë shkruar për qëllime *krishterizimi* (misionarë të krishterë) gjë që e bën secilin musliman të këtë rezerva të mëdha ndaj tyre.

Prej atyre që më së miri kanë shkruar në këtë fushë është ish-presidenti i ndjerë i BeH-së, Alija Izetbegoviç, prej ligjëratës së të cilit ne do të shkëpusim ca pjesë. “Sipas statistikave të vitit 1986¹⁵, në kontinentin evropian jetojnë 25 milionë muslimanë¹⁶... Por, jo të gjithë muslimanët – shton Izetbegoviçi – kanë pozitë të

¹⁴ Për informata më të hollësishme për gjendjen e muslimanëve në Evropën lindore shih artikullin e orientalistit hungarez Gyorgy Lederer: *Islam in Eastern Europe*, Journal Institute of Muslim Minority Affaires, vol: 13:2, July, 1992, printed in Great Britain.

¹⁵ Këto statistika, duke përfshirë muslimanët e Evropës lindore dhe perëndimore, arrijnë në 53 milionë.

¹⁶ Vetëm në Evropën perëndimore – që e përbëjnë 11 shtete – ka më shumë se 10 milionë muslimanë, dhe kjo si vijon:

1. Zvicra: 70.000-100.000
2. Gjermania: 2-3 milionë
3. Austria: 700.000 – 900.000
4. Belgjika: 500.000
5. Holanda: 750.000
6. Danimarka: 40.000
7. Suedia: 60.000 – 160.000
8. Finlanda: 2500 – 3000
9. Norvegjia: mbi 15.000
10. Britania: 1-2 milionë
11. Franca: 3 milionë

Siç mund të vërehet nuk ka ndonjë shifër të qëndrueshme të muslimanëve në Evropë për shkak të mungesës së statistikave zyrtare. Sipas parallogaritjeve të sotshme (qershor 2000), muslimanët në shtetet e sipërpërmendura arrijnë shifrën e 15 milionëshit, por ka edhe statistika që këtë shifër e ngrenë deri në 30 milionë. Kjo sa i përket shifrës së muslimanëve në Evropën perëndimore, ndërsa në atë lindore gjithsesi se janë më shumë. Sipas statistikave të fundit, muslimanët sot në Evropë janë mbi 50 milionë. Për më shumë kthehu tek: www.islammemo.cc

njëjtë. Muslimanët në BeH dhe Shqipëri¹⁷ dallojnë nga muslimanët e tjerë, ngase nuk paraqesin pakicë por shumicë. Ndërsa për rrënjët e tyre historike, ai sjell këtë ndarje:

1. Muslimanët që gjenden në pjesën evropiane të ish-Bashkimit Sovjetik
2. Muslimanët që jetojnë në Evropën perëndimorë, e që përbëhen kryesisht nga refugjatët muslimanë apo edhe evropianët e konvertuar, dhe
3. Muslimanët e Ballkanit.

Prej këtyre grupeve, grupi i parë e ka gjendjen më të vështirë dhe këtë për shkak të ideologjisë ateiste dhe shoviniste të Rusisë. Fatkeqësisht, edhe pas rënies së Bashkimit Sovjetik, me gjithë përfitimin e të drejtave fetare, prapë gjendja e tyre nuk ka ndryshuar shumë.

Ndërsa gjendja e muslimanëve në perëndim të Evropës është në varësi të institucioneve dhe kulturave të shteteve në të cilat jetojnë. Izetbegoviçi shpjegon se shkak i migrimit të muslimanëve është pozita e rëndë ekonomike në vendet e tyre të lindjes. Kurse pozita e muslimanëve ballkanas, si banorë autoktonë të këtij ishulli, ka një rëndësi më të madhe në raport me pozitën e muslimanëve në Evropë dhe raportet e tyre me të (Evropën), sidomos kur kihet parasysh kureshtja e tyre për ruajtjen e trashëgimisë islame me gjithë presionet që kanë, e që pothuajse gati i zhduken ata tërësisht, siç ndodhi në BeH, Bullgari¹⁸, Hungari¹⁹.

Ndërsa në Shqipëri²⁰ presidenti ateist, Enver Hoxha, tentoi për më shumë se një gjysmëshekulli gjatë regjimit të tij barbar ta ndante Islamin nga shqiptarët dhe ta zhvishte tërësisht këta të fundit nga feja. Sikurse që një gjë të tillë e provoi edhe ish-presidenti famëkeq i Serbisë, Slobodan Milloshevic, i cili para pak vitesh përfundoi i vdekur në një burg të Gjykatës Ndërkombëtare në Hagë, i cili me gjithë potencialin e tij ushtarak, ideologjik ortodoks dhe urrejtjen kishtare, prapë nuk ia doli. Deshi Allahu e ky kriminel dhe shokët e tij dështuan, ndërsa populli

¹⁷ Rreth lëvizjeve fetare shkatërruese dhe përpjekjeve të misionarëve të krishterë në Shqipëri shih artikullin e orientalistit hungarez Gyorgy Lederer, *Islam in Albania*, Central Asian Survey, vol: 13, No.3, pp. 331-359, printed in Great Britain.

¹⁸ Rreth pozitës dhe gjendjes së muslimanëve në Bullgari, si dhe rreth vuajtjeve që përjetuan nën regjimin e egër komunist që pati si pasojë migrimet kolektive në Turqi, shih: *Documentation – The Turkish Mionority in Bulgaria*, by: Thomas F. Michel, I.C.M.R. Vol.1, No.2, D.; *Islam in Bulgaria: a Historical Reappraisal*, by: Petya Nitzova, Religion, State, and Society, Vol.22, No1, 1994.

¹⁹ Për më shumë rreth gjendjes së muslimanëve të Hungarisë shih: Gyorgy Lederer, *Islam in Hungary*, Central Asian Survey, Vol. 11, No.1, pp.1-23, 1992, printed in Great Britain.

²⁰ Rreth gjendjes së Islamit dhe pozitës shoqërore, fetare dhe politike të muslimanëve në tokat shqiptare në kohën bashkëkohore shih: Hoxha, Hajredin, *el-Ittixhahat el fikrijje ved dinijeh fid dirasat el kur’anijeh leda ulema el alban fil asril hadith*, karn 19-20, punim doktrate, Universiteti Ndërkombëtar Islam, Malajzi, 2003, f. 30-100.

shqiptar korri fitore. Kjo falë UÇK-së, e pastaj edhe forcave ndërkombëtare, NATO-s.

Bota sot është e lidhur më shumë se kurrë më parë, dhe kjo për shkak të shkencave dhe teknologjisë bashkëkohore, mjeteve komunikuese dhe transportuese po kështu bashkëkohore, pastaj politikës, ekonomisë, sportit dhe turizmit. Bota është “tkurrur” gjeografikisht (apo siç thuhet është bërë një fshat i vogël), por fatkeqësisht distanca gjeografike ndërmjet të pasurve dhe të varfërve, ndërmjet shteteve të zhvilluara dhe shteteve të pazhvilluara, ka shënuar zgjerim të madh. Pas imperializmit ushtarak tani në skenë ka dalë imperializmi ekonomik, i cili vërtet ka bërë një bum të madh me dominimin teknologjik kudo në botë.

Ndërsa sa i përket çështjes së bashkëjetesës ndërkulturore, disa e shohin me rezervë dhe në vend të kësaj ata mendojnë se bëhet fjalë për një konflikt dhe përplasje ndërkulturore ndërmjet kulturave perëndimore dhe atyre islame. Një prej më të njohurve që ndan këtë mendim është *Samuel Huntington*, por historia ka dëshmuar të kundërtën; shumë kultura kanë bashkëjetuar, bashkëvepruar dhe ndihmuar njëra-tjetrën duke nënvizuar këtu – vërejtjet e disa analistëve – se historia e lindjes lëviz drejt perëndimit.²¹

Ndërsa sa i përket gjendjes aktuale apo rrethanave fetare, politike dhe shoqërore në BeH²² dhe Kosovë²³, analistët mendojnë se ato janë ende për të ardhur keq dhe se premtimet e bashkësisë ndërkombëtare për një zhvillim dhe përparim nuk janë realizuar veçse simbolikisht.

A është vendosur rendi dhe ligji?

A janë kthyer refugjatët në shtëpitë e tyre?

A iu janë dhënë njerëzve të drejtat prej të cilave ishin të privuar më parë?

Premtimet e bashkësisë ndërkombëtare për të rindërtuar vendet, për të kthyer sigurinë dhe për të shpenzuar miliarda dollarë, të shoqëruara këto edhe me një marketing të madh medial, nuk u realizuan as në Bosnjë, as në Kosovë, as në Maqedoni, as në Serbi dhe as në Afganistan. Përkundrazi, siç shkruante gazeta *Washington Post*, forcat ndërkombëtare të rendit dhe sigurisë në Bosnjë dhe Kosovë kanë qenë të akuzuara për shumë skandale. Këto forca (policia me theks

²¹ www.islammemo.cc, artikull i ish-presidentit boshnjak, Alija Izetbegović: *Ru'jetu Alija Izetbegovic li ved'i-l-muslimine fi Urubba*.

²² Për më shumë rreth historisë së Bosnje Hercegovinës shih: Malcolm, Noel, ***Bosnia – a short history***, Macmilan, London, 1994.

²³ Për më shumë rreth historisë antike dhe bashkëkohore të Kosovës shih: Malcolm, Noel, ***Kosovo – a short history***, Macmilan, London, 1997.

të veçantë) janë akuzuar për përfshirje në vepra të ndaluara, e më së shumti për skandale seksuale, gjë që ka shkaktuar kthimin e një numri të madh të tyre në vendet prej nga kanë ardhur. Përqindja e amerikanëve në këtë drejtim është më e madhja. Prej 1832 vetave sa janë kthyer dhunshëm në vendet e tyre, 161 kanë qenë amerikanë. Kjo natyrisht se ngjall shumë dyshime, në radhë të parë se si një kontingjent që është mykur nga brenda të mund të marrë përsipër ruajtjen e sigurisë dhe njëherësh përgatitjen e forcave lokale për rend dhe siguri?!

Këto probleme kanë bërë që krimet makabre të ushtrisë dhe qytetarëve serbë ndaj muslimanëve²⁴ të harrohen. Serbët dhunuan shumë gra, mbytën shumë qytetarë dhe varrosën në varreza masive të panjohura shumë prej tyre. Edhe pse ka kohë që lufta ka mbaruar, kërkimi për varreza masive vazhdon ende, madje nga koha në kohë zbulohen shumë prej tyre²⁵. Ushtria holandeze gjithsesi se bart një pjesë të fajit për kasaphanën e Srebrenicës. Nën “ruajtjen dhe sigurinë” e tyre u masakruan mbi 8000 muslimanë të pafajshëm, krim përgjegjësine e të cilit tash ka filluar ta pranojë qeveria holandeze.

Çfarë përfituan muslimanët boshnjakë dhe shqiptarë nga arrestimi i Slobodan Millosheviqit? Qeveritë serbe ende vazhdojnë të refuzojnë në heshtje bashkëpunimin praktik me Gjykatën Ndërkombëtare për krime lufte, ndërsa kriminelët si Ratko Mlladic dhe Radovan Karaxhixh²⁶ vazhdojnë të jenë të lirë. Nëse ky është realiteti atëherë çfarë drejtësie kanë ndarë organizatat ndërkombëtare dhe çfarë ndihme iu kanë bërë këtyre dy popujve të viktimizuar, persekutuar dhe luftuar në shekullin e njëzet?!

Këtë neglizhencë të qëllimshme të faktorit ndërkombëtar për të përmbushur obligimet karshi të drejtave politike, shoqërore dhe fetare të këtyre popujve muslimanë në BeH, Kosovë dhe Maqedoni, analistët e shohin si një viktimizim të dytë, po kështu të qëllimshëm, të popujve në fjalë. Kjo, për shkak se herën e parë të drejtat e tyre u shkelën nga lufta frontale e ushtrisë serbe, ndërsa kësaj radhe ato po shkelen nga komplotet e shteteve të mëdha brenda bashkësisë ndërkombëtare, të cilat me procedurat burokratike, nismat iluzionare dhe premtimet e kota, kanë bërë që këta njerëz të jenë shumë pesimistë dhe të mos kenë përpara vetes veçse dy zgjedhje:

1. Migrimin, ose

²⁴ Për detaje rreth luftës së shpallur kundër Islamit në Bosnje e Hercegovinë, shih: Gyorgy Lederer, *War on Islam in Bosnia*, Journal Institute of Muslim Minority Affaires, Vol. 13:2, July, 1992.

²⁵ Vetëm para pak ditësh, gjegjësisht me datë 15.03.2006 mediat ndërkombëtare raportonin për gjetjen e një varreze masive në BeH.

²⁶ Fatbardhësisht, Radovan Karaxhixhi dhe Ratko Mlladici janë arrestuar dhe janë ekstraduar për gjykim në Hagë.

2. Aderimin në rrjetet e organizuara kriminale, kushtet dhe ambienti për të cilat është i mirë si asnjëherë më parë²⁷.

Ishte kjo një përmbledhje e shkurtër rreth gjendjes së pakicave islame në perëndim, ndërsa në vijim, bashkërisht do të shohim disa prej hapave që duhen ndërmarrë për garantimin e të drejtave të tyre në perëndim.

²⁷ Shih: www.islammemo.cc, artikulli: *Muslimu el Busneh ila ejji shej'in vesalu el ane*.

KAPITULLI III:

REKOMANDIMET DHE LIGJET APLIKIMI I TË CILAVE KËRKOHEJ SI KUSHT PËR GARANTIMIN E TË DREJTAVE TË PAKICAVE MUSLIMANE

Për kapërcimin e kësaj krize dhe këtyre sfidave ideore, fetare dhe shoqërore, para botës islame dhe asaj perëndimore, pakicat islame në shoqëritë perëndimore duhet të ndërmarrin këto hapa:

- 1) Shtimi i përpjekjeve të liderëve fetarë për përforcimin e marrëdhënieve ndërnjerëzore nëpërmjet dialogut mes komuniteteve të ndryshme, luftimit të fanatizmit, unifikimit të përpjekjeve për luftimin e së keqes dhe të gjitha sjelljeve devijuese, sundimit të rendit dhe ligjit. Këto janë fusha në të cilat mund të bashkëpunohet me ithtarët e librit (çifutët dhe të krishterët)²⁸.
- 2) Që problemeve shoqërore të muslimanëve t’iu kushtohet më shumë rëndësi nga organet politike perëndimore si dhe të punohet në drejtim të trajtimit të çështjeve të tyre dhe të ngritjes së ankesave dhe kërkesave deri tek organet përgjegjëse, perëndimi doemos duhet ta pranojë se botës islame dhe muslimanëve iu ka borxh shkencor dhe kulturor.
- 3) Të njihet e drejta e muslimanëve për shkollim fillor, të mesëm dhe universitar si dhe të punohet në drejtim të zhdukjes së idesë famëkeqe për kinse fundamentalizëm islam. Kjo do të arrihej duke caktuar shkolla të veçanta dhe anekse të tjera arsimore, mu ashtu siç bëri Holanda, nën kujdesin e shtuar të së cilës janë gjashtë shkolla të veçanta dhe ashtu siç kanë çifutët dhe të krishterët shkollat e tyre të veçanta.
- 4) Trajtimi i barabartë i muslimanëve dhe ikja nga miratimi i çfarëdo ligji që do të prekte Islamit apo parimet e shenjta të tij. Ministri i Edukimit dhe Arsimit në Francë kohë më parë pati detyruar 600 vajza muslimane të hiqnin shaminë, pasi përndryshe do të përjashtoheshin nga shkolla.
- 5) Që ‘Rizgjimi islam’ në rritje, – i cili shprehet dhe manifestohet tek muslimanët e rinj, meshkuj e femra, në mbajtjen më të theksuar të parimeve fetare, në veshjen e hixhabit (shamisë), në frekuentimin e xhamive, në organizimin e takimeve fetare, për aq kohë sa manifestohen

²⁸ Për me shume këshilla dhe rekomandime përkatëse referoju: www.qaradawi.net

- në përputhje me rregullat dhe të drejtat e garantuara, – të mos i ekspozohet ndonjë formë jotransparente, intolerante a dhune.
- 6) Që muslimanëve t’iu garantohet ushtrimi i lirshëm i të drejtës politike, të drejtës zgjedhore, të drejtës për të qenë deputet parlamenti, në mënyrë që problemet e tyre të diskutohen në këto forume të larta shtetërore dhe rrjedhimisht të dalin nga ky izolim politik dhe shoqëror.
 - 7) Pakicat islame patjetër se duhet të rreshtohen pas një organi udhëheqës. Doemos duhet të kenë përgjegjës të cilët do të ngrenë zërin dhe kërkesat e tyre tek organet përgjegjëse. Vetëm kështu do të kenë zë të dëgjuar tek organet qeveritare përkatëse.
 - 8) Dijetarët dhe udhëheqësit shpirtërorë duhet të bashkëveprojnë me aktualitetin në të cilin ndodhen. Ata janë në perëndim dhe përderisa janë pakicë, atëherë duhet ta kuptojnë se janë të obliguar që të respektojnë ligjet e shteteve në të cilat jetojnë dhe assesi të mos i kundërshtojnë ato. Nuk do të duhej pasuar modeli i atyre prijësve fetarë që lëshuan dekrete (fetva) për ndalimin e pjesëmarrjes në zgjedhjet lokale për shkak se ata kinse nuk kanë nënshtetësi holandeze dhe se kandidatët e propozuar nuk ishin muslimanë.
 - 9) Perëndimorët vuajnë nga injoranca në raport me Islamin, kështu që atyre iu duhet ofruar Islami origjinal, pa shtrembëruar parimet dhe botëkuptimet e tij. Iu duhet ofruar imazhi i vërtetë i tij dhe i të Dërguarit, Muhammedit, alejhis selam, si dhe iu duhet shpjeguar se cilat janë veçoritë dhe karakteristikat e Islamit.
 - 10) Paralel me këtë vetëdijësim të perëndimorëve për Islamin, duhen vetëdijësuar edhe pakicat islame për filozofinë perëndimore dhe shumëllojshmërinë e saj etnike, kulturore dhe fetare. Po kështu, atyre iu duhet shpjeguar se ideja e Samuel Huntingtonit për përplasje ndërmjet qytetërimeve nuk qëndron dhe nuk pranohet, përkundrazi, ndërmjet muslimanëve dhe të krishterëve, siç thotë Brian Beedham²⁹, do të ketë bashkëpunim më të madh në të ardhmen.
 - 11) Të gjithë muslimanët, si ata që jetojnë në vendet e tyre, po ashtu edhe ata që janë në mërgim, duhet të luajnë një rol më të fuqishëm për përputhjen e Islamit me shkencat bashkëkohore dhe zhvillimin teknologjik dhe industrial, në mënyrë që kjo përputhje dhe pajtueshmëri të ndikojë dhe në ruajtjen e identitetit fetar dhe etnik të tyre në ambiente të paqëndrueshme shkencërisht, kulturalisht, teknologjikisht dhe industrialisht.
 - 12) Kjo pajtueshmëri dhe përputhshmëri nuk mund të arrihet nëse nuk hapet paraprakisht dera e ixhtihadit dhe nuk ripërtërihet diskursi fetar³⁰,

²⁹ Këtë mendim e mbështeste edhe Alija Izetbegoviçi.

³⁰ Për më shumë rreth kësaj shih: *Texhdid el hitab ed dinijj*, përgatitur nga: Lexhnetu el buhuth fi Merkez ed dirasat el islamijeh në Damask, i prezantuar në Seminarin *Texhdid el hitab ed dinijj* të

- sidomos tash, e me theks të veçantë në perëndim, ngase kësisoj do të tejkaloheshin sfidat dhe barrierat bashkëkohore. Nuk guxojmë assesi të njaftohemi me *ixhtihadin* e qindra vjetëve më parë.
- 13) Muslimanët vetëm tani kanë arritur të kuptojnë se komentimet klasike të Kur'anit, ato të përpiluara shekuj më parë, janë përgatitur për një mentalitet dhe ambient me shumicë muslimane. Ndërsa sot, doemos se duhet të kemi komentime të veçanta për pakicat islame, pra në rastin kur muslimanët nuk janë faktor, gjë kjo që nuk do të mund të realizohej pa kontributin e dijetarëve dhe mendimtarëve të mëdhenj ose pa ixhtihad të ri³¹.
 - 14) Perëndimi duhet të bëjë ndryshime në planprogramet mësimore në të cilat imazhi i Islamit paraqitet i shtrembëruar.
 - 15) Parandalimi i kontingjenteve të urrejtjes, të cilat ftojnë në armiqësi kulturore dhe civilizuese.
 - 16) Aprovimi i ligjeve kombëtare dhe ndërkombëtare që do të dënonin çdokënd që cenon të drejtat fetare.
 - 17) Që hidhërimi mbarëbotëror islam të stopohet, paraprakisht perëndimi duhet ta frenojë veten nga padrejtësitë dhe dhuna ndaj muslimanëve.
 - 18) Palët e interesuara për paqe, nga muslimanët dhe të tjerët, duhet ta vënë veten në shërbim të gjetjes së mënyrave për lidhje dhe dashuri ndërmjet njerëzve në vend të urrejtjes dhe armiqësisë ndërmjet tyre³².
 - 19) Themelimi i faqeve islame shumëgjuhëshe në internet, të cilat do të merreshin vetëm me prezantimin e Islamit dhe personalitetit të Muhammedit, alejhis selam.
 - 20) Mbjellja e të vërtetave islame tek perëndimorët dhe pakicat islame se Islami është një fe që e shikon njerëzimin si një familje shumëtnike dhe shumëgjuhëshe, të cilët duhet të jetojnë në paqe, duhet ta pranojnë njëri-tjetrin, duhet të dialogojnë ndërmjet vete dhe se ata janë vëllezër nga ky aspekt, pra i krijimit dhe llojit. Allahu ka thënë:
O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se tek All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat), e All-llahu është shumë i dijshëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë. (Kur'ani: el-Huxhurat, 13.)

organizuar nga Universiteti i Damaskut, 2004 (www.altajdeed.org). Po kështu shih edhe: *El Islam bejnet texhdidil matlub vet tebdilil mefrud* të Dr. Butit në www.bouti.com

³¹ Për hollësi të jetës së muslimanëve në perëndim shih punimin e Zeki Bedevit në revistën Afak el Islam: *The reality of the situation of muslims in the West*, f. 32-43, 2 mars 1995.

³² Për zgjidhje dhe propozime adekuate kthehu tek www.amrkhaled.net

- 21) Mbjellja e parimit islam tek perëndimorët dhe pakicat tona se Islami është fe e tolerancës, faljes, mëshirës, dhe se shembull për këtë kemi Kur'anin, mësimet e të cilit vazhdojnë të shndrisin botën, dhe Sunnetin e të Dërguarit të Allahut, Muhammedit, alejhis selam, i cili në vazhdimësi reflekton paqen, mirësinë, butësinë, tolerancën, mirësjelljen...
- 22) Mbjellja e idesë islame në shpirtat e perëndimorëve dhe pakicave islame se kjo fe e ndalon sharjen dhe ofendimit e tjetrit, nënçmimin dhe poshtërimin e tij, mu ashtu siç thotë Allahu:
Ju mos ua shani ata (zota) që u luten (idhujtarët), pos All-llahut, e (si hakmarrje) të fyejnë All-llahun nga armiqësia, duke mos ditur (për madhërinë e Tij). Kështu Ne ia kemi zbukuruar çdo populli veprimin e vet, mandej e ardhmja e tyre është te Zoti i tyre, e Ai i shpërblen për atë që vepruan. (Kur'ani: el-En'amë, 108.)
- 23) Fitneja (përçarja) duhet izoluar, zjarri i saj duhet shuar, gjë kjo që pa një mund të përbashkët dhe dialog ndërmjet vete nuk do të mund të realizohej.
- 24) Bashkëpunimi i pakicave islame me perëndimorët për të përhapur moralin e mirë njerëzor dhe vlera të tilla si: sinqeriteti, besnikëria, nderi, krenaria, pozitivizmi, liria. Po kështu, do të duhej të ishin tok edhe për luftimin e sjelljeve devijuese dhe moralit të keq, si: gënjeshtria, mashtrimi, vjedhja, prostitucioni, lëndët narkotike. Këto janë fusha në të cila do të mund të bashkëvepronin pakicat islame dhe perëndimorët.
- 25) Gjë tjetër që do t'i bashkonte palët është edhe shkëmbimi i ndërsjellë material, kulturor, shkencor, tregtar etj³³.
- 26) Përkrahja dhe ndihma për personalitetin dhe figurën e Muhammedit, alejhis selam, assesi nuk guxojnë të përkthehen në përpjekje të dhunshme për të demoluar, djegur dhe shkatërruar pronat e të tjerëve. Ne i dënojmë sulmet e fundit ndaj ambasadave holandeze dhe norvegjeze në Bejrut dhe Damask. Alternativë janë mjetet e informimit dhe mjetet e tjera ligjore që prodhojnë efekte të dëshiruara dhe që, në radhë të parë, nuk ndeshen me rregullat, normat dhe parimet fetare.
- 27) Për të zbutur disi dhimbjen dhe pikëllimin e muslimanëve dhe lëndimin e ndjenjave të tyre, shteti holandez por edhe shtetet e tjera perëndimore duhet të jenë sa më shumë pozitive dhe më realiste në trajtimin e kësaj krize aktuale. Nuk mjafton vetëm dënimi i rasteve por gjithsesi duhen ndërmarrë edhe hapat konkretë për të ndëshkuar ata që prishën rendin dhe sigurinë, të paktën për të kërkuar falje publikisht, përndryshe dënimet e tyre do të duhej të ishin shumë të rënda³⁴.

³³ Për më shumë referoju www.amrkhaleed.org

³⁴ Për më shumë rreth trajtimit të kësaj krize ktheju: www.islamtoday.net

- 28) T'u shpjegohet perëndimorëve dhe pakicave islame se feja islame, me të gjitha rregullat dhe parimet e saj, përshtatet me natyrën dhe kërkesat e njeriut. Ajo ka ardhur për të ruajtur dhe garantuar të drejtat e njeriut, çfarëdo që qoftë feja apo drejtimi i tyre. Këtë transparencë nuk e gjen dot në asnjë fe tjetër³⁵.
- 29) T'u themi perëndimorëve: “Mos i shqetësoni muslimanët dhe mos keni frikë nga Islami!” ngase Islami i vërtetë nuk paraqet rrezik për ju dhe as për kulturën tuaj. Islami, në fakt, është ilaçi që ruan kulturën tuaj nga shkatërrimi dhe garanton shërimin e saj nga sëmundjet...
- 30) O ju perëndimorë! Rreziku i vërtetë për ju dhe kulturën tuaj është degjenerimi dhe çoroditja, të cilat u mishëruan edhe me perandorinë romake dhe e shkatërruan atë. Në raportet tuaja me kozmosin (gjithësinë) i jeni kthyer tërësisht aspektit lëndor, materiales, teknikes, ndërsa keni harruar se këto janë vetëm mjete në shfrytëzimin tuaj dhe jo se meritojnë *adhurimin* tuaj. Shkenca faktikisht merret, në radhë të parë, me vetë njeriun:
- a) Kush është ai?
 - b) Prej nga vjen?
 - c) Si është fundi i tij?
 - d) Ç'ushqim duhet t'i ofrojë shpirtit?
 - e) Ç'rëndësi ka morali për të?

Kjo fatkeqësi është ajo që birit të kulturës perëndimore i ka dhuruar një boshllëk në të menduarit, ndjenjat, ndërjegjen, raportet me gjithësinë... Me gjithë këto boshllëqe dhe mungesë ndjenjash shpirtërore, disa prej tyre prapë i sheh tek merren shumë me shkencë, politikë, probleme shoqërore, derisa të tjerët, që vuajnë nga kjo mungesë ndjenjash dhe që nuk i pranojnë, i sheh të ikin nga ky realitet dhe mundohen ta harrojnë atë duke konsumuar alkool, lëndë narkotike, duke bërë jetë të shturur ideore, seksuale, krime, e çka jo tjetër?! 40% e shkollave fillore në Amerikë praktikojnë dhënien e dozave të lëndëve narkotike për nxënësit e tyre dhe këtë nën përkujdesjen e *mjekëve specialistë* për të arritur atë nivelin apo *balancimin intelektual* të nevojshëm tek ta. Ky është rreziku që kërcënon kulturën perëndimore dhe jo Islami. Po shtrohet pyetja: si është shërimi?

- 31) Shërimi konsiston me interesimin më të madh të perëndimit për njeriun si tërësi dhe për njohjen me kërkesat e tij shpirtërore dhe kërkesat e tjera të domosdoshme, si dhe angazhimin serioz për t'i dhënë përgjigje pyetjeve të parashtruara më parë, nëpërmjet një metodologjie të thuktë shkencore larg çdo miti dhe iluzioni. Ose thënë më shkurt dhe më qartë, ai që garanton shërimin dhe shpëtimin tuaj është vetëm Islami.

³⁵ Për më shumë shih intervistën e Dr. Vehbe Zuhajlit në gazetën Al Vatan, www.zuhayli.net

- 32) Ne nuk iu thërrasim që ta përqafoji Islamin verbërisht. Ne ju thërrasim që të njiheni me Islamin larg çdo miti a ideje të huaj, ngase kështu vetvetiu do të bindeni për atë se mësimet e tij përputhen me të arriturat tuaja shkencore dhe rrjedhimisht edhe do të gjeni prehjen shpirtërore tek ai.
- 33) Ajo që duhet apriori të bëni është zhveshja dhe çlirimi nga ato bindjet dhe iluzionet se kinse Islami paraqet rrezik permanent për ju. Atë duhet ta merrni si mik të sinqertë, si strehim shpirtëror, duhet ta studioni mirë e pastaj ta përqafoji pa dhunë, presion a imponim.
- 34) Islami është shpëtim për pleqërinë e kulturës perëndimore para se atë ta zërë vdekja...³⁶
- 35) Pakicat islame kanë obligime karshi shoqërisë në të cilën jetojnë. Parimi i mirësjelljes dhe përmbushjes së obligimeve parasheh që të ketë shkëmbime ndërmjet tyre dhe shoqërisë në të cilat jetojnë. Nëse perëndimi iu ka ofruar atyre shkencë, teknikë dhe gjëra të tjera, atëherë ata duhet t'i ofrojnë perëndimit bazamentet e kulturës islame, që i mungon perëndimit dhe për të cilat ai ka nevojë më së shumti.
- 36) Nëse muslimanët vuajnë nga mungesa e të mirave materiale, atëherë perëndimorët vuajnë nga problemet shpirtërore dhe shoqërore, nga perceptimet e gabuara në ide dhe besim, dhe po kështu edhe nga problemet në shëndetin psikik – nervor. Tërë kjo nënkupton se për muslimanët ka ardhur koha që ta ushtrojnë rolin e tyre për të shpëtuar shoqërinë njerëzore në përgjithësi dhe atë perëndimore në veçanti nga humnera dhe degjenerimi dhe të gjitha sëmundjet dhe problemet e tjera, shifrat e të cilat rriten nga dita në ditë në perëndim....³⁷
- 37) Muslimani duhet të jetë shëmbëlltëri për rrethin ku jeton. Ai duhet të ofrojë një imazh të vërtetë dhe imponant të Islamit, si dhe jetësojë në praktikë mësimet e tij. Kësisoj, ai do t'i ofrojë shoqërisë perëndimore një model të një muslimani të vërtetë që do të kishte si rezultat edhe shkëmbimin ndërkulturor dhe dialogët përkatës. Kjo, siç po shohim, vërteton faktin se nuk guxojmë që në thirrjen tonë të mjaftohemi vetëm me fjalë apo me shkrime.
- 38) Pakicave islame në perëndim iu mbetet për obligim që të jenë pikë referimi për familjarizimin me rrethin dhe ambientin, jo për shkrirje, asimilim dhe humbje të identitetit, por për moralin dhe edukatën brilante e cila këtyre

³⁶ Pjesë të shkëputura nga një artikull i gjatë me titull: “*Nesihati ilel garbijjine el eldhine jetehavvefune el jevme minel Islam*” të Dr. Muhammed Seid Ramadan el Butit, të publikuar në faqen personale të tij në internet: www.bouti.com

³⁷ Shih artikullin “*El xhalijat el islamijjeh fil garb ve mesulijjetuha tuxhahel muxhtemeil garbijj*” të publikuar në www.islammemo.cc Artikulli sjell shifra tmerruese të rasteve të shkurorëzimit, vetëvrasjes, dhunës familjare, mbyrtjes së grave, SIDA-s, e sëmundjeve dhe problemeve tjera në shoqërinë perëndimore.

- pakicave do t'iu japë pozitë nderi dhe respekti në mesin e këtyre shoqërive perëndimore.
- 39) Pakicat islame duhet të respektojnë ligjet në fuqi të shoqërive në të cilat jetojnë, për aq kohë sa ato janë hartuar për të respektuar qenien njerëzore dhe për të siguruar rendin, sigurinë dhe stabilitetin shoqëror. Kjo është pikë e përbashkët e parimeve islame dhe ligjeve në fjalë.
- 40) Kjo nënkupton se pakicat islame duhet të jenë ambasadorë të sinqertë të fesë së tyre, gjë të cilën nuk do të mund ta realizojnë kurrë nëse Islami, mësimet dhe morali i tij nuk janë të mëshiruara në personalitetin e tyre. Vetëm kështu do të mund të ndikojnë në shoqëritë perëndimore dhe të gjejnë respektin e duhur për ta.
- 41) Fajin për shtrembërimin e imazhit islam në perëndim të tjerët ia hedhin pikërisht pakicave islame, për shkak se ata nuk e përfaqësojnë denjësisht Islamin. Fjalët dhe veprat e tyre janë larg njëra-tjetrës sikur lindja dhe perëndimi. Ata bartin emrin e Islamit, ndërsa në fakt sjelljet dhe veprat e tyre janë në kundërshtim të plotë me të³⁸.

A thua vallë do të shpëtojë shoqëria njerëzore prapë nëpërmjet duarve të muslimanëve?

A do të jenë muslimanët shkak për lumturinë njerëzore dhe shpëtimin e saj të sërishëm?

Le të shpresojmë se po dhe ta lusim Allahun për një gjë të tillë, sikurse që e lusim edhe në fund të këtij punimi dhe shprehim të gjitha falënderimet dhe lëvdatat tona për Të!

Dr. Hajredin Hoxha

18.03.2006

Bibliografia

1. Abiva, Huseyin, *Muslim Minorities Face Increasing Hostility in the Balkans*, The international message – North America's Magazine, September, 1991.
2. Lopasic, Alexander, *Islamization of the Balkans with special reference to Bosnia*, Journal of Islamic Studies, 5:2, 1994.
3. Abid, Safet, *Europes's endangered species: Yugoslavia's forgotten muslims, A survey of the indigenous muslims of Bosnia and Herzegovina-*

³⁸ Ibid.

- Past histori – Current situation – Future prospects*, The message international, September, 1991.
4. Gyorgy Lederer, *Islam in Eastern Europe*, Journal Institute of Muslim Minority Affairs, Vol: 13:2, July, 1992, printed in Great Britain.
 5. Gyorgy Lederer, *Islam in Albania*, Central Asian Survey, Vol.13, No.3, pp: 331-359, 1994, printed in Great Britain.
 6. *Documentation – The Turkish Minority in Bulgaria* by Thomas F. Michel, I.C.M.R. Vol.1, No.2, D.
 7. *Islam in Bulgaria: a Historical Reappraisal*, by Petya Nityova, Religion, Satet and Society, Vol.22, No.1, 1994.
 8. Gyorgy Lederer, *Islam in Hungary*, Central Asian Survey, Vol.11, No.1, pp:1-23, printed in Great Britain.
 9. Malcolm, Noel, *Bosnia – a short history*, Macmilan, London, 1994.
 10. Malcolm, Noel, *Kosovo – a short history*, Macmilan, London, 1997.
 11. Gyorgy Lederer, *War on Islam in Bosnia*, Journal Institute of Muslim Minority Affairs, Vol. 13:2, July, 1992.
 12. Badawi, Zaki, *The reality of the situation of Muslims in the West*, Afaq al-Islam, 2nd – March, 1995.
 13. *Islamic community of Bosnia & Herzegovina*, Center for Islamic Architecture, Sarajevo, 1995.
 14. En-Nahvijj, Adnan Ali Rida, *El muslimune bejnel vakii vel emel*, b.1, 2003, Daru-n-Nahvijj li-n-neshri ve-t-tevzië.
 15. Hoxha, Hajruddin, *El ittixhahat el fikrijeh ve-d-dinijeh fi-d-dirasat el kur'anijeh leda ulemai-l-Alban fil asril hadith - el karn XIX-XX*, Disertacion doktorate, Universiteti Nderkombetar Islam në Malajzi, 2003.
 16. www.islammemo.cc, artikulli: *El muslimune fi Belxhika*.
 17. www.islammemo.cc, artikulli: *Kul-lu muslimii Amerika tahte-rr-rrekabeh*.
 18. www.islammemo.cc, artikulli: *Kejfe jendhur el Garb ilet Islam*.
 19. www.islammemo.cc, artikulli: *El muslimune fi Svisra*.
 20. www.islammemo.cc, artikulli: *Muslimu el Busneh ila eji shej'in vesalu ilel ane*.
 21. www.islammemo.cc, artikulli: *El xhalijat el islamijeh fil garbi ve mesulijetih tuxhahe-l-muxhtemel el garbijj*.
 22. www.islammemo.cc, artikulli: *Ru'jetu Ali Izetbegoviç li ved'i-l-musline fi Urubba*.
 23. www.qaradawi.net
 24. www.bouti.com, artikulli: *El Islamu bejne texhdidi-l-matlub vet-tebdilil mefrud*.
 25. www.bouti.com, artikulli: *Nesihati ilet garbijjine el eldhine jetehavvefune el jevme minel Islam*.

26. www.amrkhaled.net
27. www.islamtoday.net
28. www.altajdeed.org
29. www.zuhayli.net